



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1653/1 Prot.

Tiranë më, 28.08 2026

Lënda: Për një ndryshim në afatet e lëvizjeve paralele për vitin shkollor 2026-2027.

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

Bazuar në Ligjin Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 08, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 14 datë 10.07.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar me udhëzimin nr.16, datë 27.08.2026, në vijim të shkresës së Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar nr. 1653 prot., datë 15.06.2026 “Mbi procedurat e lëvizjeve paralele për vitin shkollor 2026-2027, afatet për lëvizjet paralele me detyrim dhe me dëshirë të mësuesve do të jenë si vijon:

1. Procedura e vlerësimit të dosjeve të mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore, për vitin 2026-2027 në nivel shkolle të kryhet brenda datës 01.09.2026, duke u mbështetur në kriteret e shtojcës 2 të Udhëzimit nr. 08, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit , të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.
2. Drejtuesi i institucionit arsimor, brenda datës 01.09.2026, përcjell me shkresë zyrtare në ZVAP-in përkatës shtojcën 2, të plotësuar për mësuesin/it që në vlerësimin e dosjeve të

kryer nga KVD-ja e shkollës, ka/kanë dalë me më pak pikë dhe ka/kanë ngelur pa ngarkesë mësimore.

3. ZVAP dërgon në DRAP-in përkatës, brenda datës 02.09.2026, me shkresë zyrtare listën e mësuesve që në vlerësimin e dosjeve të kryer nga KVD-ja e shkollës, ka/kanë dalë me më pak pikë dhe ka/kanë ngelur pa ngarkesë mësimore
4. KVD-ja e DRAP-së rendit për çdo ZVAP sipas profileve, mësuesit që kanë ngelur pa ngarkesë mësimore dhe mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele në të njëjtën ZVAP. Këto lista i publikon në faqen zyrtare të DRAP-së, si dhe i dërgon për publikim në ZVAP-në përkatëse brenda datës 03.09.2026.
5. Vendet e lira të punës që janë krijuar brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesve të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore (lëvizje paralele e detyruar) brenda datës 04 shtator 2026.
6. Vendet e lira të punës të mbetura pas lëvizjes paralele me detyrim, brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesve të cilët kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë, sipas profileve dhe renditjes, brenda datës 04 shtator 2026.
7. Në rast se në ZVAP-të e tjera të DRAP-së rezulton se pas njoftimit për punësim, ka vende të lira pune, atëherë këto vende u ofrohen kandidatëve të papunësuar të të gjitha ZVAP-ve në juridiksion, të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore, sipas profileve, duke filluar me kandidatin me më shumë pikë. brenda datës 08 shtator 2026.
8. DRAP-i njofton AKAP-in me shkresë zyrtare në datën 08 shtator 2026, në lidhje me punësimet e kryera, e cila i heq nga lista e publikuar këto vende të lira pune.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arta Dollani

